



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

FTESË PËR PJESËMARRJE

Arkivat dhe puna arkivore në trevat e shqiptarëve në shek. XX – XXI

Konferencë Ndërkombëtare e Arkivistikës organizuar me bashkëpunimin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave (Kosovë) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (Shqipëri)

Data: 9 qershor 2018

Vendi: Prishtinë (vendi i saktë do të komunikohet së shpejti).

Gjuhët e Konferencës: shqip dhe anglisht.

Qëllimi i kësaj konference është të mbledhë bashkë arkivistët e Shqipërisë dhe të Kosovës, arkivistët shqiptarë të viseve jashtë Shqipërisë, por që veprojnë ndër shqiptarë, nga Maqedonia dhe Mali i Zi, si dhe të tjerë arkivistë që punojnë apo studiojnë në fushë të arkivistikës. Temat që propozohen për diskutim lidhen specifikisht me arkivistikën, por edhe me historinë e arkivave apo institucioneve arkivore në zonat shqipfolëse. Veç arkivistëve të rrjeteve arkivore kombëtare, ftesa për pjesëmarrje u drejtohet të gjithë profileve të tjerë të arkivistëve, institucioneve që ruajnë apo atyre që ndërveprojnë me ruajtjen e kujtesës kolektive.

Temat bosht:

1. Përshkrimi i lëndës arkivore sipas standardit ISAD(G);
2. Arkivat në Epokën digjitale;
3. Arkivat Private;
4. Qasja në dokumente arkivore sipas standardeve të ICA-së;
5. Mbrojtja e lëndës arkivore.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ftojnë gjithë të interesuarit të dërgojnë abstraktet e artikujve të propozuar deri më dt. 20 prill 2018, ora 19:00, në adresat:

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës: ark.kosoves@rks-gov.net

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave: dpa@albarchive.gov.al,

Shpresa Mekaj (AShAK): shpresa.mekaj@rks-gov.net

Sokol Çunga (AQSh-DPA): sokol.cunga@albarchive.gov.al,